



Datë: 29.12.2025
Numër Protokolli: 8121/2025

A.nr.1807/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1807/2025 të datës 16.10.2025, të parashtruar nga ankuesi I.O përmes përfaqësuesit me autorizim avokat Qendrim Arifi, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet ankesa Anr.1807/2025 e datës 16.10.2025 e parashtruar nga ankuesi I.O dhe **Anulohet** Vendimi me numër të protokollit 63/2025, i datës 16.09.2025, i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Bordi i KRPP-së

II. Obligohet Kryetari i KRPP që në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij sipas pikëpamjeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, I.O (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 16.10.2025 përmes përfaqësuesit me autorizim avokat Qendrim Arifi, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6840/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër 63/2025 të nxjerr nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.11.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6840/2025 të datës 16.10.2025 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit të ankuesit të datës 25.04.2016; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim të lëshuar në vitin 2020; Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 31.12.2024; Kërkesën për Rishqyrtim të datës 05.01.2025; Ankesën me numër protokolli 622-24-11677-2-2-1 të datës 19.01.2025; Vendimin e OSHP-se të datës 13.03.2025; Njoftimi mbi vendimin me numër të prokurimit 622-24-11677-2-2-1 të datës 21.03.2025; Vendimin e datës 28.03.2025 lidhur me aprovimin për rishqyrtimin e kërkesës OE; Ankesën me numër të protokollit 622-24-11677-2-2-1 të datës 07.04.2025; Vendimin me numër OSHP:2025/0244 të datës 19.05.2025; Kërkesën me numër protokolli 622-24-11677-2-2-1 për rishqyrtim të datës 27.05.2025; Vendimin me numër OSHP:2025/0515; Konkluzionin për ndryshime të vendimit me numër protokolli 1070/25 të datës 31.07.2025.

Kolegji i këshillit fillimisht ka konstatuar kompetencën lëndore lidhur me ankesën dhe ka konstatuar se ekziston bazë ligjore për trajtimin e ankesës dhe se në bazë të provave të lëndës ankesa është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës është konstatuar statusi i ankuesit sikur në hyrje të këtij arsyetimi, ankuesit me datë 19.09.2025 me vendimin nr.63/2025, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (me tutje KRPP) ankuesit i ka revokuar Certifikatën e Avancuar Profesionale për Prokurim Publik të vitit 2020 me arsyetimin se ankuesi nuk ka zbatuar vendimin Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (tutje OSHP).

Nga shkresat e lëndës të bashkëngjitur nga palët në procedurë rrjedhë se OSHP ka nxjerr tre vendime lidhur me këtë procedurë dhe atë, Vendimin OSHP: 2025/0055 të datës 13.03.2025 sipas të cilit vendim lënda e prokurimit me nr. 622-24-11677-2-2-1, e iniciuar nga Komuna e Prizrenit është rikthyer në vlerësim duke anuluar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 21.12.2024 (B58 formular standard që përdoret në aktivitetet e prokurimit publik), ndërsa Komuna e Prizrenit me datë 21.03.2025 sipas formularit standard B58 anulon në tersi aktivitetin e prokurimit, ndërsa një palë e autorizuar kërkon rishqyrtim të këtij vendimi dhe AK aprovon kërkesën dhe lëndën përsëri e rikthen në rivlerësim, pala e autorizuar kundër këtij njoftimi me datë 07.04.2025 parashtron ankesë në OSHP, ndërsa kjo e fundit me datë 19.05.2025 nxjerr Vendimin OSHP: 2025/0244 me të cilin refuzon ankesën e palës së autorizuar dhe lenë në fuqi Formularin B 58 të datës 21.03.2025 (edhe pse në dispozitiv OSHP nuk përcakton se formularin e cilës datë e lenë në fuqi nga shkresat e lëndës nënkuptohet) ndërsa AK respektivisht Komuna e Prizrenit bënë dhënien e kontratës duke vepruar jo sipas pamajmeve të Vendimit të OSHP të datës 13.03.2025 dhe duke mos e pezulluar aktivitetin e prokurimit pas ankesës së datës 07.04.2025, por më datë 22.05.2025 bënë njoftimin përmes formularit standard për dhënien e kontratës sipas nr. të prokurimit 622-24-1677-2-2-1. Pas këtyre veprime të përshkruar me datë

27.05.2025 pala e autorizuar në procedurë parashtron kërkesë për rishqyrtim tek AK, por këta të fundit me datë 30.05.2025 i refuzojnë kërkesën, ndërsa pala e autorizuar parashtron ankesë në OSHP, ndërsa OSHP me datë 31.07.2025 nxjerr vendimin OSHP: 2025/0515 me të cilin anulon në tersi aktivitetin e prokurimit në fjalë, ndërsa këtë vendim e korrigjon me Konkluzionin Nr. 1070/25 datë 31.07.2025 korrigjon dispozitivin e vendimit në fjalë ku përcaktohet iniciimi për revokimin e licencës profesionale të prokurimit të ankuesit I.O.

Ndërsa me datë.31.07.2025, OSHP i drejtohet me kërkesë KRPP lidhur me revokimin e licencës së ankuesit, ndërsa KRPP me datë 04.08.2025 nxjerr vendimin me nr. 45/2025 me të cilin themelon Komisionin për trajtimin e kërkesës së OSHP-së lidhur me procedurën e prokurimit nr. 622-24-11677-221, KRPP me datë 19.09.2025 me vendimin nr.63/2025 bënë revokimin e Certifikatës Profesionale të Prokurimit Publik AK-Komuna e Prizrenit respektivisht ankuesit I.O

Nga të lartë përshkruarat konstatohet pa asnjë dyshim se ankuesi ka bërë shkelje duke mos respektuar vendimin e OSHP-së datë 13.03.2025 për të pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe anulimin e tij, prandaj kjo në bindjen e Kolegjit është një shkelje e rëndë e detyrave të punës së nëpunësit civil dhe ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik respektivisht nenin 28 Detyrimi për respektim të ligjit 1. ***Zyrtarja/i publik ka për detyrim të respektojë Kushtetutën, ligjin dhe ka për detyrim të mbroj interesin publik dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Zyrtarja/i publik ushtron detyrat e saj/tij dhe vepron me profesionalizëm, paanësi, mos diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kodin e etikës.***

Por megjithatë, Kolegji ka parasysh shkeljet procedurale të KRPP gjatë revokimit të licencës së ankuesit të cilën do ta sqaroj në këtë vendim (*është sqaruar edhe në vendimin A.nr.1141/2023*), marrja e certifikatës profesionale të prokurimit publik për Zyrtarët Publik të cilët kanë statusin e nëpunësit civil është përcaktuar në dispozitat ligjore si vijon, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar se i njëjti është nxjerr mbi bazën e nenit 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092) si dhe nenin 98 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 25 paragrafi 8 të ligjit bazik për prokurim publik gjegjësisht Ligjit Nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-068, me të cilin është përcaktuar se: *Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të filloj trajnimin bazik. 9. Në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuara në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit. Në rast se KRPP-ja konstaton*

se kushtet e përmendura janë plotësuar, KRPP-ja do të vazhdoj me procedurat e theksuara në paragrafin 8 të këtij neni.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa A.nr.1837/2025 është e pranueshme, mbi bazën se ankuesi ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë, ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me paragrafin 2 i cili parasheh: "2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.....", dhe Ligjin Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku parasheh:"1.1.Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil “.*

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti është nxjerr mbi bazën e nenit 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092) si dhe nenin 98 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 25 paragrafi 8 të ligjit bazik për prokurim publik gjegjësisht Ligjit Nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-068, me të cilin është përcaktuar se: *Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të filloj trajnimin bazik. 9. Në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuara në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit. Në rast se KRPP-ja konstaton se kushtet e përmendura janë plotësuar, KRPP-ja do të vazhdoj me procedurat e theksuara në paragrafin 8 të këtij neni.*

Në këtë aspekt, dhe duke u nisur nga fakti së ankuesi ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji konstaton së marrëdhënia e punës së nëpunësve civil është e rregulluar me Ligjin Nr.08/L-197 dhe rrjedhimisht, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik krijimi, ndryshimi si dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, rregullohet vetëm sipas këtij ligji, e mbi këtë bazë rezulton

se lidhur me procedurën disiplinore gjegjësisht lidhur me inicimin e procedurës ndaj nëpunësve civilë, vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore dhe masave disiplinore, aplikohen vetëm dispozitat e kapitullit IV të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, në kontekst të kuadrit ligjor si me lart, Kolegji konstaton së shqiptimi i masës disiplinore ndaj ankuesit nga Bordi i KRPP-së përmes vendimit me numër të protokollit 63/2025, i datës 16.09.2025, është në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik dhe Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse, konstatimi i shkeljeve të ligjit për prokurimin publik si shkelje disiplinore, mund të behët vetëm nga organi kompetent sipas nenit 55 dhe 56 të Ligjit për Zyrtarët Publik. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit, OSHP-ja dhe KRPP-ja në rast se gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre ligjore, pretendojnë se zyrtari i caktuar i prokurimit ka bërë shkelje të legjislacionit të prokurimit, mund të iniciojnë procedurë disiplinore ndaj zyrtarit në fjalë tek organi kompetent në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik apo që paraprakisht të themelojnë (e drejtë kjo që buron nga ligji bazik për prokurimin publik) komisione ad hoc për hetim të shkeljes së legjislacionit të prokurimit publik, dhe mbi bazën e të gjeturave të komisioneve mund të iniciojnë procedurë disiplinore kundër zyrtarit të prokurimit në pajtim e legjislacionin e shërbimit civil.

Në lidhje me konstatimin si me sipër, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkitazi me disiplinën në shërbimin civil, me theks të veçantë :

Neni 55 Përgjegjësia disiplinore 1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim. Përgjegjësia penale nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore, nëse shkaku i kallëzimit penal përbën edhe shkeljen e detyrave apo përgjegjësive të punës. 3. Lirimi nga përgjegjësia penale nuk nënkupton përjashtim nga përgjegjësia disiplinore, nëse vepra e kryer paraqet shkelje detyrave apo përgjegjësive të punës.

Neni 56 Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive 1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësive të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi

i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 57 Masat disiplinore 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil.

Neni 58 Kompetenca për shqiptimin e masës disiplinore 1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ. 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor.

Neni 59 Procedura disiplinore 1. Procedura disiplinore fillon mbi bazën e dyshimit të bazuar për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil, duke mos përjashtuar informatat e pranuar në mënyrë anonime. 2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil. 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunës/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

Pas zhvillimit të procedurës disiplinore nga ana e Autoritetit kontraktor gjegjësisht Komunës së Prizrenit, KRPP nuk është e lidhur nga vendim marrja e autoritetit kontraktues, KRPP në fund të procesit duhet të veproj plotësisht e pavarur në përputhje me Ligjin Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik respektivisht me nenin 86 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik 1. KRPP është agjenci e pavarur rregullatore, që do të thotë se asnjë zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim në KRPP në lidhje me ndonjë veprim ose vendim të caktuar operacional apo rregullativ të KRPP-së.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1807/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtëse

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim Avokat Qëndrim Arifi;
- Kryetarit të Bordit të KRRPP
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.